

E ndiej ndërkaq që nga dera aromën e librave të vjetër, një erë fletësh të ngrëna dhe lëkure të vjetruar. Dyqanet e tjera të antikave para të cilave kam kaluar përgjatë kësaj rrugicës me kalldrëm i kanë kondicionerët ndezur dhe dyert mbyllur për t'u mbrojtur nga vapa, por dera e këtij dyqani është krejt e hapur, si të jetë duke më ftuar të futem. Është pasditja e fundit në Romë, rasti i fundit për të blerë një suvenir nga udhëtimi im. Kravatën e mëndafshit për Robin dhe fustanin plot me rrudha për vajzën tonë tre-vjeçare, Lilin, e kam blerë, por për veten nuk kam gjetur gjë. Pashë pikërisht atë që dëshiroja në dritaren e dyqanit të antikave.

Errësira ku futem është aq e dendur saqë syve u duhet pak kohë për t'u mësuar. Vapa jashtë është mbytëse, por këtu çuditërisht është fresk, si të kem hyrë në një shpellë ku nuk depërton as i nxehti e as drita. Trajtat marrin formë ngadalë dhe arrij të dalloj rafte të ngjeshura me libra, baule të vjetra dhe një armaturë të nxirë në cep. Nëpër mure janë varur piktura në vaj, të shëmtuara e të tepruara të gjitha, të zbukuruar me tabelat e verdha të çmimeve. Ngaqë nuk e vë re që pronari po qëndron te kthina, trembem kur krejt papritur më thërret duke folur italisht. Kthehem dhe më zënë sytë një xhuxh të vogël me vetulla si larva të bardha.

- Më vjen keq, - i përgjigjem. "*Non parlo italiano*".

"*Violino*"? Tregon me gisht këllëfin e violinës që kam në shpinë. Instrument tepër me vlerë për t'u lënë në dhomën e hotelit, ndaj kur udhëtoj, e mbaj gjithnjë me vete. "*Musicista*"? - më pyet ai dhe bën sikur i bie në ajër, me krahun e djathtë duke lëvizur sa andej-këtej me një hark imagjinar.

- Po, muzikante jam. Nga Amerika. Interpretova në festival, në mëngjes. Nuk besoj se më kupton, ndonëse tund kokën me mirësjellje. I tregoj artikullin që vura re në vitrinën e tij. - Mund ta shoh pak atë librin? "*Libro. Musica*".

Ai zgjatet te vitrina për të marrë librin dhe ma jep në dorë. E dalloj që është i vjetër nga mënyra sesi cepat e fletëve shkërmoqen kur e prek. Është botim italisht dhe në kopertinë ka fjalën *Cigan* dhe figurën e një burri me flokë të shprishur duke i rënë violinës. E hap për të parë melodinë e parë e cila është shkruar në çelës minor. Është pjesë e panjohur, një melodi vajtuese të cilën gishtat nuk presin dot ta luajnë. Po, këtë

dal të kërkoj kurdoherë, muzikë të vjetër që është harruar dhe meriton të zbulohet rishtas.

Ndërsa shfletoj meloditë e tjera, një fletë e shkëputur bie dhe luhetet deri në dyshe me. Nuk është fletë e librit, por një partiturë e mbushur me rreshta plot nota të shënuara me laps. Titulli i kompozimit është shkruar me kaligrafi elegante.

*Incendio*, kompozuar nga L. Todesco.

Arrij t'i dëgjoj notat në kokë teksa e lexoj muzikën dhe pas disa masash, jam e bindur që ky vals është i bukur. Nis si melodi e thjeshtë në mi minor. Por te masa e gjashtëmbëdhjetë, muzika bëhet më e ndërlikuar. Kur arrin te masa e gjashtëdhjetë, notat nisin të mbivendosen dhe ka alteracione të befta. E kthej nga ana tjetër dhe çdo masë është e mbushur me shenja lapsi. Një varg arpexhosh me shpejtësi rrufeje e kthen melodinë në një vorbull të furishme notash të cilat më bëjnë të ngjethem.

Kjo muzikë duhet të bëhet e imja.

- "Quanto costa?" - pyes. - Kjo fletë dhe libri?

Pronari më vështron me një shkëlqim të çuditshëm në sy.

- "Cento". Nxjerr një stilolaps dhe e shkruan numrin në pëllëmbë.

- Njëqind euro? Talleni më duket.

- "É vecchio". I vjetër.

- Nuk është edhe aq i vjetër.

Mbledhja e supeve do të thotë të zgjedh e të marr. Ma ka vënë re tashmë urinë në sy, e di që mund të më thotë një çmim absurd për këtë vëllim që të shkërmoqet në dorë melodish cigane dhe unë do ta paguaj prapëseprapë. Muzika është teprimi im i vetëm. Nuk më interesojnë bizhuteritë apo veshjet e këpucët e markave. Aksesori i vetëm që çmoj vërtet është violina njëqind vjeçare që mbaj në shpinë.

Ai më jep faturën e blerjes dhe unë dal nga dyqani për t'u përfshirë nga i nxehti ngjitës si shurupi. Sa çudi që përbrenda ndieja ftohtë. I kthej sytë pas nga ndërtesa, por nuk shoh kondicioner, vetëm dritare të mbyllura dhe gojka binjake mbi ballinë. Një rreze drite dielli më bie nga pasqyrimi i çekanit prej tunxhi të derës me formë të kokës së Meduzës. Dera është mbyllur tani, por mospërmas dritares plot pluhur dalloj pronarin që më vështron, pikërisht para se të ulë grilën dhe të zhduket.

... *pasioni për librat*

Robi, im shoq, është entuziazmuar me kravatën e re që i bleva në Romë. Qëndron para pasqyrës së dhomës së gjumit, duke e lidhur me duart eksperte rreth qafës. - Ishte fiks ajo që më duhej për të gjallëruar një mbledhje të mërzitshme, - më thotë. - Mbase i mbajnë zgjuar këto ngjyra kur të filloj të flas për shifrat. Në moshën tridhjetë e tetë vjeçare, është po aq elegant dhe në formë sa ditën që u martuam, ndonëse këto dhjetë vite i kanë shtuar tëmthave fije të argjendta. Me këmishën e bardhë të ngrirë e butonat e artë të manshetave im shoq, i rritur në Boston, duket pikërisht ai që është, një ekonomist i kujdesshëm. Shifrat janë gjithçka për të: fitimet dhe humbjet, aktivet

dhe detyrimet. E sheh botën sipas termave matematikore, madje edhe mënyra sesi lëviz diç ka nga gjeometria e përpiktë; kravata formon një hark, duke bërë zig-zag derisa krijon një nyje të përkryer. Sa të ndryshëm jemi! Të vetmet shifra që më interesojnë mua janë numrat e simfonive, opuseve dhe metri i masave të muzikës sime. Prandaj e tërhiqja u thotë Robi të gjithëve, sepse ndryshe nga ai, unë jam artiste dhe krijesë e ajrit e cila kërcen në dritën e diellit. Shqetësohesha se mos ndryshimet tona do të na detyronin të ndaheshim, se mos Robi, vendosmërisht me këmbë në tokë, do të lodhej duke e ruajtur gruan krijesë të ajrit që të mos fluturonte tej nëpër re. Dhjetë vjet më pas, ama, ja ku jemi, ende të dashuruar.

Më buzëqesh nga pasqyra teksa shtrëngon kravatën në fyt. - Shumë herët u zgjove sot, Xhulia.

- Funksionoj ende me orën e Romës. Atje ka shkuar ora dymbëdhjetë e drekës tani. Kjo është e mira e ndryshimit të orës. Mendo sa gjëra kam për të mbaruar sot.

- Them se aty nga dreka do kesh marrë fund. Do ta çoj unë Lilin në kopsht?

- Jo, dua ta mbaj në shtëpi sot. Ndihem në faj që s'kam qenë gjithë javën me të.

- S'ka pse. Teze Vali erdhi dhe u kujdes për gjithçka, siç bën gjithmonë.

- Më ka marrë shumë malli dhe sot dua të kaloj çdo minutë me të.

Kthehet për të më treguar kravatën e re, të vendosur përsosurisht në qendër të qafës. - Ç'plane ke?

- Aq vapë sa është, them të shkojmë te pishina. Mbase edhe te ndonjë librari për të zgjedhur libra të rinj.

- Plan i bukur. Përkulet për të më puthur dhe fytyra e saporruar i bie erë tarte me qitro. - Sa inat e kam kur nuk je këtu, shpirt, - murmurin. - Mbase herën tjetër e marr javën pushim dhe ikim bashkë. A s'do të ishte shumë më tepër...

- Mami, shiko! Shiko sa bukur! Lili, vajza jonë trevjeçare, kërcen nëpër dhomë dhe rrotullohet e veshur me fustanin që i solla nga Roma, fustanin që provoi mbrëmë dhe tani nuk pranon ta heqë. Turret papritur si raketë drejt krahëve të mi dhe biem duke qeshur të dyja në shtrat. Nuk ka gjë më të ëmbël sesa aroma e vajzës sime dhe unë dua t'i thith çdo molekulë, ta kthej sërish në trupin tim në mënyrë që të bëhemi përsëri një. Teksa përqafoj lëmshin e flokëve të verdhë e rrudhave lejla, në shtrat hidhet edhe Robi, duke na përqaftuar të dyjave.

- Dy vajzat më të bukura në botë, - thërret. - Dhe janë të miat, të gjitha të miat!

- Rri në shtëpi, babi, - e urdhëron Lili.

- Sa do të doja ta bëja, zemër. Robi i jep një të puthur me zhurmë në kokë dhe ngrihet me përtesë në këmbë. - Babit i duhet të shkojë në punë, po je a s'je vajzë me fat? Do ta kalosh gjithë ditën me mamin.

- Shkojmë të veshim rrobat e banjës, - i them Lilit. - Do kalojmë shumë bukur bashkë, vetëm unë dhe ti.

Dhe ia kalojmë shumë bukur. Lahemi në pishinën e lagjes. Për drekë hamë pica me djathë dhe akullore dhe shkojmë në librari, ku Lili zgjedh dy libra të rinj me figura, me kafshën që i pëlqen më shumë, gomarin. Por në orën tre të pasdites, kur kthehem

në shtëpi, jam pothuaj në gjendje kome nga rraskapitja. Siç parashikoi Robi, ndryshimi i orës e dha efektin dhe nuk kishte asgjë tjetër që doja veçse të futesha në shtrat e të flija.

Për fat të keq, Lilit nuk i flihet fare dhe nxjerr kutinë e rrobave të saj të vjetra në verandë, ku Xhuniperi, maçoku ynë, po merr një sy gjumë. Lili ka shumë qejf ta veshë me rroba Xhuniperin dhe i ka lidhur tashmë një kapelë në kokë dhe po mbulon një nga putrat me mëngë. Maçoku ynë i dashur plak e duron, siç ka bërë gjithmonë, moskokëçarës ndaj poshtërimit të dantellave dhe fluturave.

Ndërsa Xhuniperi vishet sipas modës, unë nxjerr violinën dhe pupitrin në verandë dhe hap librin e melodive cigane. Fleta e shkëputur rrëshqet përsëri dhe më bie para këmbëve me pjesën e shkruar lart. *Incendio*.

Nuk ia kam hedhur më sytë kësaj muzike që nga dita kur e bleva në Romë. Teksa e mbërthej te pupitri tani, më vjen ndër mend dyqani i antikave, pronari, duke përgjuar si krijesë shpellash nga kthina. Krejt papritur më shkojnë mornica nëpër të gjithë trupin, sikur i ftohti i dyqanit të mos jetë shkëputur ende nga kjo muzikë.

Marr violinën dhe nis të luaj.

Këtë pasdite të lagësht, instrumenti tingëllon më i thellë, më i pasur se kurrë, toni i ngrohtë dhe i butë. Tridhjetë e dy masat e para të valsit janë të bukura siç i përfytyroja, vajtim i pikëlluar baritoni. Por te masa e dyzet, notat përshpejtohen. Melodia merr kthesa të njëpasnjëshme, plot alteracione dhe ngrihet në pozicionin e shtatë në telin E. Nëpër fytyrë djersa më rrjedh çurg teksa përpiqem të qëndroj e intonuar dhe të mbaj tempin. Harkun e ndiej sikur vazhdon vetë, sikur lëviz si me magji dhe unë mundohem ta shtrëngoq që të mos më ikë. Oh, ç'muzikë e lavdishme! Ç'pjesë për t'u interpretuar, nëse arrij ta përvetësoj. Notat shkasin nëpër pentagram. Befas e humb gjithë kontrollin dhe gjithçka bëhet e stonuar, dora e majtë më mpihet teksa muzika shkon drejt frenezisë.

Këmbën ma mbërthen një dorë e vogël. Lëkurën ma njollon diçka e ngrohtë dhe e lagësht.

Ndaloj së luajturi dhe ul sytë. Lili më shikon me sytë e kthjellët si ujë i kaltër. Sytë e saj bojë qielli nuk trazohen fare as kur hidhem përpjetë e tronditur dhe i rrëmbej nga dora e përgjakur veglën e kopshtit. Këmbët e saj të zbathura kanë lënë shenja mbi pllakat e verandës. Gjithnjë e më e tmerruar ndjek shenjat e këmbëve deri te burimi i gjakut.

Kur mbërrij, ia jap ulërimës.